

Cila është mbrojtja më e mirë kundër gripit ?


Vaksinimi çdo vit përpara fillimit të sezonit të gripit është mënyra më e mirë për të:

- Zvogëluar rrezikun e marrjes së gripit
- Zvogëluar rreziqet për paraqitjen e sëmundjeve të rënda, hospitalizimin dhe vdekjen.

Nëse jeni shtatzënë dhe keni një problem ekzistues shëndetësor, vaksinimi është posaçërisht i rëndësishëm - si për ju ashtu dhe për foshnjën tuaj.

A është i sigurt vaksinimi kundër gripit?

Po, vaksinimi është i sigurt. Çdo efekt anësor i vaksinimit kundër gripit zakonisht është i butë dhe përfshin dhimbje dhe skuqje në vendin e injektimit. Disa njerëz përjetojnë dhimbje koke, dhimbje në muskuj, ethe, lodhje dhe neveri. Për dallim nga gripit, këto efekte anësore janë të lehta dhe kalojnë shpejt.




Vaksinimi është i sigurt

www.euro.who.int/en/fluaware



GRIPIT MUND TË JETË SERIOZ NËSE KENI PROBLEME SHËNDETËSORE

Vaksinohu !





Gripi mund të jetë shqetësues nëse veç më keni ndonjë problem tjetër shëndetësor

Shumica e njerëzve që kanë grip, shërohen shpejt pa patur nevojë për kujdes shëndetësor. Megjithatë, për njerëzit me probleme shëndetësore, gripi mund të jetë një sëmundje e rëndë, madje dhe fatale. Për shembull, nëse keni diabet, ose problem me zemren ose frymëmarrjen, gripi mund ta përkeqësojë shëndetin tuaj.

Pse disa probleme shëndetësore rrisin rrezikun ndaj gripit si një sëmundje e rëndë?

Infeksioni nga gripi mund të përkeqësojë gjendjen ekzistuese si p.sh. problemet e zorrës, diabetin ose sëmundjet kronike të mushkërive dhe të rezultojë me hospitalizim.

Gjithashtu, njerëzit me probleme shëndetësore ka më shumë gjasa që të kenë një sistem imunitar të dobësuar, për shkak të vetë sëmundjes ekzistuese (p.sh. infeksioni me HIV, diabeti) ose për shkak të trajtimit të tij (p.sh. steroidet, kimioterapia). Kjo e bën më të vështirë luftën kundër infeksionit të gripit dhe rrit rrezikun për paraqitjen e komplikimeve, siç është pneumonia.

Cfarë është gripi?

Gripi është një sëmundje infektive që përhapet nga personi në person kryesisht nga kollitja, teshtima dhe nga kontakti i afërt. Simptomat e gripit fillojnë papritur dhe mund të zgjasin nga disa ditë deri në disa javë. Simptomat e zakonshme përfshijnë ethe dhe drithërima, kollë, dhimbje të fytyrës, dhimbje koke, dhimbje në muskuj dhe lodhje.

Cilat gjendje ekzistuese shëndetësore rrisin rrezikun ndaj gripit?

Një numër sëmundjesh kronike ose probleme ekzistuese shëndetësore mund të rrisin rrezikun e komplikimeve të rënda nga gripi.

Këtu përfshihen:

Obeziteti ekstrem, astma, sëmundja kronike e mëlçisë, terapia kronike e aspirines tek fëmijët, sëmundje kronike të veshkave, sistemi imunitar i dobësuar, sëmundje kronike të mushkërive, sëmundjet e zorrës, diabeti, sëmundjet neurologjike dhe çrregullimi neuro-zhvillimor.

